



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

PSH. nr. 1122/17

PANELI SHQYRTUES i emëruar nga kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2017, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga autoriteti kontraktues (AK) “Korporata Energjetike e Kosovës”, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të Operatorit Ekonomik: “Bubeari Comerc” nga Kaçanik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me gazra industriale për KEK”, me numër të prokurimit: KEKO 17/281/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - / Korporata Energjetike e Kosovës / më: 18. 01. 2018, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet, si e pa bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) - “Korporata Energjetike e Kosovës”, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “Bubeari Comerc” nga Kaçanik lidhur me procedurën e prokurimit me titull “Furnizim me gazra industriale për KEK”, me numër të prokurimit: “KEKO 17/281/111”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) / Korporata Energjetike e Kosovës /.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues / Korporata Energjetike e Kosovës / me dt: 15 dhjetor 2017, ka parashtruar kërkesë në OSHP, që të shqyrtohen mundësitë e veprimit konform nenit 99 të LPP-së, për diskualifikim të OE “Bubeari Comerc” nga Kaçanik.

Përkitazi me kërkesën e AK-së për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të operatorit ekonomik "Bubeari Comerc" nga Kaçanik, eksperti shqyrtues ka përgatitur një kronologji të cilën ia ka dorëzuar panelit shqyrtues me dt: 29 dhjetor 2017.

Lidhur me kërkesën e lartpërmendur OSHP-ja ka mbajtur seancën dëgjimore me dt: 18 janar 2018, ku kanë marr pjesë paneli shqyrtues, përfaqësuesi i AK-së dhe i OE, eksperti shqyrtues i OSHP-së.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE deklaroj: "Certifikata e kontestuar nga AK, është certifikatë e kompanisë SOL, të njëjtën ashtu si e kam pranuar e kam dorëzuar përmes ofertës tonë. Ne në kërkesën e AK nuk kemi kuptuar fjalën link dhe gojarisht tek AK kemi kërkuar sqarim, mirëpo afati për ti dhënë përgjigje AK-së do thotë linkun ka qenë i limituar në dy ditë pune".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK- KEK sh. a deklaroj: "Ne si AK kemi dyshuar në këtë certifikatë, kemi kërkuar në internet sipas numrit të certifikatës dhe kemi bërë pyetje sqaruese tek OE, mirëpo nuk kemi mund të vërtetojmë as pozitive as negative, dhe pasi nuk është përgjigjur në pyetje OE kemi vazhduar me eliminim. Element që ka bërë dyshoj AK-në për këtë certifikatë janë data e lëshimit dhe data skadimit, data lëshimit është 03. 06. 2016 dhe me datë të skadimit 02. 06. 2019. Në internet sipas numrit të certifikatës kur kemi bërë hulumtimet, nuk kemi mundur të gjejmë të njëjtën certifikatë".

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z. Sheqiri deklaroj: "Me gjithë dyshimet e ngritura prej AK-KEK, deri më tani nuk ka prova – dëshmi nga institucione kompetente për të vërtetuar pretendimet e AK-KEK, andaj në situatë të tillë nuk mund të jap rekomandim për diskualifikim të OE në fjalë".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE "Bubeari Comerc" z. Guri i cili deklaroj: "Kërkojmë që të refuzohet kërkesa e AK- KEK si e pabazuar".

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK z. Emërllahu deklaroj: "I propozojmë panelit të merr vendim lidhur me këtë lëndë duke i ndihmuar AK- KEK lidhur me kërkesën e parashtruar në mënyrë që edhe në të ardhmen të veprojmë konform vendimit të OSHP-së".

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se autoriteti kontraktues në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë nuk ka mundur të dëshmojë se certifikata ISO 9001:2008 e prodhuesit "SOL S. P. a" me numër IT- 1975 e lëshuar nga trupa certifikuese IQNET, është e falsifikuar.

Paneli shqyrtues në mungesë të dëshmive dhe argumenteve të ofruara nga AK që certifikata e lartpërmendur është e falsifikuar vjen në përfundim se kërkesa e AK-së, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin elektronik të operatorit ekonomik “Bubeari Comerc”- Kaçanik është e pabazuar dhe e paqëndrueshme, pasi që AK nuk ka arritur të verifikoj dhe konstatoj se dyshimet që i ka janë të bazuara, në mënyrë që OSHP të marrë masa për falsifikim të dokumentacionit.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - “Korporata Energjetike e Kosovës”
- 1x1 OE - “Bubeari Komerc”- Kaçanik
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.